



INDEKSI

# I TRANSPARENCËS

Shtator

2019



Embassy of the United States of America  
Tirana, Albania



Embassy of the United States of America  
Tirana, Albania

Ky publikim është pjesë e projektit “Rritja e aksesit të gazetarëve *investigues në informacionin zyrtar*” që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Botues: Qendra “Res Publica”  
Blv. Gjergj Fishta, Nd. 24, H.3, Ap.44, Tiranë, Shqipëri

Përgjegjës dhe përgatitja grafike: Dorian Matlija

© Qendra “Res Publica”, Tiranë, 2019

# TREGUESI I LËNDËS

.....	5
.....	6
.....	9
.....	9
.....	17
.....	22
.....	23
.....	26
.....	27

## I. HYRJE

## II. METODOLOGJIA

## III. INDEKSI

Transparenca Proaktive

Transparenca Reaktive

Rezultati Agregat

## IV. TË TJERA

## V. KONKLUSIONE

## VI. REKOMANDIME



# I. HYRJE

## DY FJALË PËR PROJEKTIN

Ky raport u përgatit nga Qendra Res Publica, me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla i për Demokraci i Ambasadës së SHBA-së në Tiranë.

Res Publica ka një eksperiencë të gjatë në lidhje me të drejtën e informimit, si dhe numëron disa studime në këtë fushë, të shoqëruara me një numër rekomandimesh për përmirësimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe zbatimin e tij në praktikë.

Bazuar në studimet e mëparshme, Res Publica ka vijuar monitorimet e institucioneve dhe synon të informojë publikun në lidhje me institucionet më transparente dhe ato më pak transparente.

Monitorimi i institucioneve është bërë nga muaji Nëntor 2018 deri në muajin Shtator 2019 dhe renditja e tyre është bërë në bazë të një metodologjie komplekse. Rënditja e institucioneve është publikuar online në faqen online [www.publeaks.al](http://www.publeaks.al)

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi se si institucionet publike zbatojnë ligjin për të drejtën e informimit, duke pasur parasysh jo vetëm publikimin e informacioneve pa kërkesë nga publiku, por edhe si reagojnë institucionet publike ndaj kërkesave për informacion që dërgojnë qytetarët.

Një pjesë e studimit fokusohet te reagimi i institucioneve kur marrin kërkesa për informim edhe nga gazetarët investigues.

Në fund të studimit jepen rekomandime se si ligji mund të përdoret si një instrument i rëndësishëm në duart e gazetarëve investigativ, por edhe cilat janë mënyrat që ligji të përmirësohet dhe institucionet publike ta zbatojnë me efektivitet atë.

Autorë të studimit janë:

- Av. Dorian Matlija
- Dr. Irena Dule

Ndihmuan:

- Av. Brunilda Qershori
- Diana Malaj

### 20 autoritete varësie të pushtetit ekzekutiv

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë  
Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë  
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave  
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve  
Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë  
Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave  
Drejtoria e Përgj. e Shërbimeve të Transportit Rrugor  
Agjencia e Trajtimit të Konkencioneve  
Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave  
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve  
Drejtoria e Përgjithshme Detare  
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve  
Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare  
Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit  
Agjencia e Trajtimit të Pronave  
Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar  
Instituti i Shëndetit Publik  
Inspektoriati Qendror  
Agjencia e Inventarizimit & Transf. të Pronave Publike  
Inspektoriati i Punës

### 20 autoritete vendore

Bashkia Shkodër  
Bashkia Tropojë  
Bashkia Kukës  
Bashkia Lezhë  
Bashkia Dibër  
Bashkia Durrës  
Bashkia Klugë  
Bashkia Tiranë  
Bashkia Kavajë  
Bashkia Elbasan  
Bashkia Pogradec  
Bashkia Korçë  
Bashkia Lushnjë  
Bashkia Fier  
Bashkia Berat  
Bashkia Vlorë  
Bashkia Himarë  
Bashkia Tepelene  
Bashkia Gjirokastrë  
Bashkia Sarandë

## II. METODOLOGJIA

### CILËT AUTORITETE PUBLIKE U MONITORUAN

Për realizimin e këtij raporti janë përzgjedhur për t'u monitoruar 100 autoritete publike, të ndarë në mënyrë të barabartë në 5 kategori:

1. Organe kushtetuese dhe të pavarura;
2. Organe qendrore të pushtetit ekzekutiv;
3. Autoritete të pushtetit vendor;
4. Autoritete që i përkasin pushtetit gjyqësor;
5. Institucione varësie të organeve ekzekutive.

Përzgjedhja përfshiu grupe të ndryshme institucionesh, sipas shtyllave kryesore të pushteteve (ekzekutive, legjislative, gjyqësore).

Një nga kriteret e përzgjedhjes ishte edhe rëndësia e kompetencat e tyre. Në praktikë, 100 autoritetet e përzgjedhur janë më të rëndësishmit.

### 20 organe qendrore të pushtetit ekzekutiv

Kryeministria  
Ministria e Kulturës  
Ministria e Drejtësisë  
Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministria e Shtetit për Diasporën  
Ministria e Mbrojtjes  
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Ministria e Ekonomisë dhe Financave  
Ministria e Arsimit dhe Sportit  
Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmartimit  
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropës  
Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë  
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit  
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural  
Prefektura Tiranë  
Prefektura Berat  
Prefektura Dibër  
Prefektura Durrës  
Prefektura Elbasan  
Prefektura Fier

### 20 autoritete të pushtetit gjyqësor

Gjykata e Lartë  
Gjykata Administrative e Apelit Tiranë  
Gjykata e Apelit Tiranë  
Gjykata e Apelit Shkodër  
Gjykata e Apelit Gjirokastrë  
Gjykata e Apelit Vlorë  
Gjykata e Apelit Durrës  
Gjykata e Apelit Korçë  
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës  
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër  
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë  
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë  
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan  
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë  
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier  
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë  
Prokuroria për Krimet e Rënda  
Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda  
Prokuroria e Përgjithshme  
Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë

### 20 organe kushtetuese & të pavarura

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë  
Këshilli i Lartë i Gjyqësorit  
Presidenti i Republikës së Shqipërisë  
Kontrolli i Lartë i Shtetit  
Gjykata Kushtetuese  
Agjencia Kombëtare e Mjedisit  
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit  
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare  
Autoriteti i Konkurrencës  
Avokati i Popullit  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Instituti i Sigurimeve Shoqërore  
Drejtoria e Markave dhe Patentave  
ALUZIONI  
Kolegji i Posaçëm i Apelit  
OSHEE  
Agjencia e Prokurimit Publik  
Komisioni i Pavarur i Kualifikimit  
Komisioneri për të Drejtën e Informimit  
Komisioneri Publik

# METODOLOGJIA


Për qëllime studimore, Res Publica e ka ndarë konceptin e transparencës në dy kategori kryesore:

## Transparenca proaktive

e autoriteteve publike, e cila manifestohet me publikimin pa kërkesë të një kategorie informacionesh, që ligji e quan “programi i transparencës”

## Transparenca reaktive

e autoriteteve publike, e cila manifestohet me kthimin e përgjigjeve të plota dhe brenda afatit ndaj kërkesave për informacion



Sipas skemës së mësipërme, dy kriteret kryesore mbi të cilat bazohet vlerësimi janë:

- Sasia dhe cilësia e përmbushjes së programit të transparencës, dhe;
- Mënyra se si institucionet publike kanë reaguar ndaj kërkesave për informacion.

Të dhënat për studimin janë marrë nga monitorimi i vazhdueshëm i faqeve online të autoriteteve publike, si dhe në bazë të kërkesave për informacion që i janë dërguar, duke ruajtur balancën në numrin e kërkesave drejtuar secilit grup institucionesh.

Vlerësimi/pikësimi është kryer duke vlerësuar pozitivisht dhe negativisht institucionet e monitoruara, sipas një shkalle që shkon nga -100 pikë deri në +100 pikë. Me pikë pozitive është vlerësuar përmbushja dhe publikimi i informacioneve që duhet të përmbajë programi i transparencës. Ndërsa me pikë negative është vlerësuar sjellja penguese e institucioneve kur

ata nuk janë përgjigjur ndaj kërkesave për informacion, duke marrë si komponentë të vlerësimit përgjigjet e plota apo të pjesshme, rastet e refuzimit, respektimin e afatit ligjor, ekzekutimin e vendimeve të Komisionerit, të gjykatave etj.

Vlerësimi është llogaritur mbi bazën e një mesatareje mbi të dhënat që janë mbledhur gjatë periudhës së monitorimit, Shtator 2018 - Qershor 2019.

Në vijim të gjetjeve të nxjerra në monitorimet e mëparshme të zbatimit të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, Res Publica ka monitoruar edhe kërkesat e dërguara nga gazetarët investigues, duke bërë një krahasim mes gjetjeve aktuale dhe ato të monitorimeve të mëparshme.

# METODOLOGJIA

Për të pasur një tablo të plotë se si funksionon **transparenca proaktive** janë vlerësuar 100 autoritetet publike më të rëndësishëm. Res Publica ka vlerësuar gjithashtu edhe sjelljen e institucioneve në rastin e trajtimit të kërkesave për informacion të dërguara nga qytetarët, gazetarët, aktivistët, etj. Janë dërguar gjithsej 515 kërkesa për informacion, prej të cilave 84 janë pyetje të bëra nga gazetarët investigues.

Ky aspekt është i një rëndësie të veçantë sepse një institucion mund të publikojë shumë informacione pa kërkesë, por nga ana tjetër mund të mos përgjigjet ndaj kërkesave specifike, çka mund të minojë transparencën.

Reagimi negativ i autoriteteve publike është vlerësuar me pikë negative, duke i zbritur ato nga pikët e fituara nga performanca në lidhje me programet e transparencës.

Në përfundim është nxjerrë një rezultat agregat i cili ka shërbyer për të bërë renditjen e përgjithshme të transparencës.

Vlerësimi i kombinuar sjell si rezultat që një autoritet që publikon shumë informacione pa kërkesë mund të renditet më poshtë se një autoritet tjetër që nuk ka program transparence, por që përgjigjet në mënyrë korrekte ndaj kërkesave për informacion. Res Publica e vlerëson **transparencën reaktive** si tepër të rëndësishme për renditjen, pasi ajo ofron pamjen e vërtetë të hapjes së një institucioni, pikërisht kur prej tij kërkohen informacione që vetë institucioni nuk do t'i bëjë publike me nismën e tij.

Gjithsesi, Res Publica ka bërë një vlerësim të barazpeshuar për të dyja kategoritë, duke ruajtur balancën në vlerësimin përfundimtar.





# INDEKSI / TRANSPARENCA PROAKTIVE

## III. INDEKSI


### TRANSPARENCA PROAKTIVE, REAKTIVE DHE AGREGATE

Sipas ligjit, institucionet detyrohen të bëjnë publike një kategori të caktuar informacionesh, pa kërkesë nga publiku. Kjo kategori publikohet në të ashtuquajturin *program transparence* (rubrikë e posaçme në faqen e internetit). Modeli i këtij programi është miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit.

Programet e transparencës përfshijnë disa kategori informacionesh që për efekt vlerësimi janë ndarë në tre grupe kryesore:

1. Në grupin e parë përfshihen informacione që aksesohen kudo, pasi këto janë akte ligjore dhe nënligjore ose informacione që gjenden në to;
2. Në grupin e dytë përfshihen manuale dhe dokumenta lidhur me aktivitetin e institucionit;
3. Në grupin e tretë përfshihen informacione me karakter më të ndjeshëm, prej nga mund të zbulohen shkelje apo mundësi abuzimi, si prokurimet publike, auditimet, etj.

**Fig.1- Indeksi i përgjithshëm i transparencës proaktive të institucioneve gjatë 2019**




# INDEKSI / TRANSPARENCA PROAKTIVE

Nga grafiku i mësipërm, rezulton që ka një përmirësim të lehtë vetëm gjatë tre muajve të parë të vitit. Më pas situata mbetet pa ndryshime. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së programeve të transparencës, që në Janar 2019 ishte 19.5%, shënoi pikën më të lartë në muajt Maj-Qershor 2019, në masën 26.5%. Ndonëse shumë e ulët, kjo është shifra më e lartë e regjistruar nga Res Publica që në vitin 2014 kur u

miratua ligji i ri. Nga renditja rezulton se 5 institucionet me program transparence më të përmbushur janë Bashkia Shkodër 86 pikë (shifër rekord krahasuar me të gjithë vitet e mëparshme), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 75 pikë, Komisioneri Publik 73 pikë, Gjykata e Lartë 71 pikë dhe Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare 67 pikë.

**Fig.2 – Indeksi i transparencës sipas kategorive të institucioneve**



Kategoria e institucioneve kushtetuese dhe të pavaruara, si dhe kategoria e institucioneve të pushtetit qendror janë në një situatë më të mirë krahasuar me të tjerat. Vihet re një përmirësim i lehtë në muajt e parë të vitit 2019.

Ka një rënie në muajt Qershor-Korrik për të cilin mendojmë se vjen për shkak të situatës së prodhuar nga zgjedhjet e tensionuara për pushtetin vendor në 30 Qershor 2019. Grupi i

institucioneve të prekur duket qartë që janë ato të pushtetit ekzekutiv qendror dhe ato të pushtetit vendor, si institucionet më të përfshira në fushatë dhe në procesin zgjedhor.

Rritje të ndjeshme në këto muaj kanë pësuar institucionet sipas tabelës së mëposhtme:

# INDEKSI / TRANSPARENCA PROAKTIVE

Autoriteti publik	Pikët Janar 2019	Pikët Shtator 2019
Bashkia Elbasan	0	65
Gjykata e Lartë	35	71
Bashkia Lushnje	0	30
Prefektura Tiranë	0	29
Bashkia Shkodër	58	86

Një fakt shqetësues që evidentohet është që nga muaji Mars 2019 ka një frenim të përmirësimit të mëtejshëm, madje e shoqëruar me përkeqësim në disa raste, duke u ndalur në vlera shumë të ulëta, në mesatare prej vetëm 25.7%, më e ulët edhe se viti 2017 ku kjo vlerë ishte 26.1%. E ndarë sipas grupeve të institucioneve, mesatarja e vitit 2019 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Përmirësim, ndonëse të parëndësishëm, kanë pasur institucionet kushtetuese dhe

ato të pushtetit gjyqësor. Kategoritë e tjera kanë pasur ulje të vlerave, krahasuar me vitet e mëparshme (shoqëruar me rreth 12% rënie relative).

Theksojmë që disa institucione të pushtetit ekzekutiv kanë mbajtur qendrim refuzues edhe ndaj kërkesave për informacion, ndërkohë që roli i tyre është tepër i rëndësishëm për qytetarët, ku vlen për të shtuar se ky rol është veçanërisht i rëndësishëm në rastin e institucioneve të varësisë (drejtoritë e ndryshme).



Grupi i autoriteteve publike	Përbushja e programit të transparencës	
	2017	2019
Institucione të pushtetit ekzekutiv qendror	36.8%	33.3% ▼
Institucione kushtetuese dhe të pavarur	33.3%	36.1% ▲
Institucione të pushtetit vendor	22.8%	19.4% ▼
Institucione të pushtetit gjyqësor	21.0%	22.0% ▲
Institucione të varësisë	16.5%	14.6% ▼

# INDEKSI / TRANSPARENCA PROAKTIVE

## SHEMBUJT MË POZITIVË DHE ATO MË NEGATIVË LIDHUR ME TRANSPARENCËN PROAKTIVE


### INSTITUCIONET KUSHTETUESE DHE TË PAVARURA

Komisioneri për të Drejtën e Inforimit	75	Këshilli i Lartë Gjyqësor	14
Komisioneri Publik	73	Komisioni I Pavarur I Kualifikimit	1
Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	67	Presidenti i Republikës	0
ALUIZNI	67	Autoriteti i Aviacionit Civil	0
Autoriteti i Konkurrencës	61	Inspektoriati Qendror	0



### INSTITUCIONET QENDRORE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV

Ministria e Kulturës	67	Prefektura Berat	0
Ministria e Shëndetësisë & Mbrojtjes Sociale	61	Prefektura Dibër	0
Ministria e Punëve të Brendshme	59	Prefektura Elbasan	0
Ministria e Mbrojtjes	53	Prefektura Fier	0
Ministria e Punëve të Jashtme & për Evropën	52	Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	0





# INDEKSI / TRANSPARENCA PROAKTIVE

## SHEMBUJT MË POZITIVË DHE ATO MË NEGATIVË LIDHUR ME TRANSPARENÇËN PROAKTIVE



### INSTITUCIONET E PUSHTETIT VENDOR

Bashkia Shkodër	86	Bashkia Krujë	0
Bashkia Elbasan	65	Bashkia Gjirokastrë	0
Bashkia Durrës	50	Bashkia Sarandë	0
Bashkia Korçë	49	Bashkia Tropojë	0
Bashkia Tiranë	48	Bashkia Tepelenë	0



### INSTITUCIONET E PUSHTETIT GJYQËSOR

Gjykata e Lartë	71	Gjykata e Apelit Durrës	17
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	52	Gjykata Administrative e Apelit	0
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë	33	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan	0
Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	33	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	0
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	27	Prokuroria për Krimet e Rënda	0



# INDEKSI / TRANSPARENCA PROAKTIVE

## SHEMBUJT MË POZITIVË DHE ATO MË NEGATIVË LIDHUR ME TRANSPARENCËN PROAKTIVE

### INSTITUCIONET E VARËSISË

Drejtoria e Përgj. Shërb. Transp. Rrugor	40	Drejtoria e Përgj. e Ujësjetës Kanalizime	0
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	31	Drejtoria e Përgjithshme Detare	0
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	28	Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë	0
Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	26	Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë	0
Drejtoria e Përgj. e Pronësisë Industriale	23	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	0

### INSTITUCIONE QË KANË SHËNUAR PROGRES OSE REGRES TË NDJESHËM

	Nga	Në
Bashkia Shkodër	58	86
Gjykata e Lartë	35	71
Agjencia e Prokurimit Publik	20	56
Bashkia Elbasan	0	65
Bashkia Durrës	26	50
Prefektura Tiranë	0	29
Bashkia Lushnje	0	30


PËRMIRËSIM

	Nga	Në
Ministria e Bujqësisë & Zhvill. Rural	66	18
Drejtoria e Përgj. Ujësjetës Kanal.	39	0
Prokuroria e Përgjithshme	34	20
Gjykata Administrative e Apelit	33	0
Inspektoriati Qendror	26	0
Gjykata e Apelit Shkodër	21	0
Agjencia e Trajt. të Konkencioneve	38	19

PËRKEQËSIM

# INDEKSI / TRANSPARENCA PROAKTIVE

Fig. 3 - Shpërndarja e institucioneve sipas pikëve të grumbulluara për transparencën proaktive



Nga grafiku i mësipër rezulton se zhvillimi i programeve të transparencës nuk është aspak i kënaqshëm.

Nga 100 autoritetet më të rëndësishëm kuptojmë se 25% nuk kanë fare një program transparence. Madje disa autoritete nuk kanë as faqe interneti. Pjesa më e madhe e autoriteteve, siç duket edhe nga grafiku, është vlerësuar me 11 deri 50 pikë,

që do të thotë se kanë përbushur më pak se gjysmën e kërkesave të ligjit.

Vetëm 16% e autoriteteve kanë plotësuar më shumë se gjysmën e kërkesave ligjore dhe asnjë autoritet nuk ka arritur të përbushë plotësisht programin e transparencës. Krahasuar me dy vjet më parë, situata nuk ka asnjë përmirësim.


# INDEKSI / TRANSPARENCA PROAKTIVE

## SIPAS KATEGORIVE TË INFORMACIONIT TË PUBLIKUAR

Për të pasur një tablo sa më të plotë, se si është zbatuar programi i transparencës, kemi bërë një nëndarje të programit në 14 kategori informacionesh që rrjedhin nga ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si më poshtë:

<b>A</b>	Informacion për strukturën organizative dhe funksionet e autoritetit publik;	<b>F</b>	Informacion për shërbimet që jep autoriteti publik dhe standardet për cilësinë e shërbimit;
<b>B</b>	Informacion për publikimin e konventave/ligjeve/akteve nënligjore etj.;	<b>G</b>	Informacion për procedurat e ankesave dhe kërkesave etj.;
<b>C</b>	Informacion për procedurat e bërjes së një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozimin e kërkesës dhe procedura e ankimit;	<b>GJ</b>	Informacion për procedurat ku personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre për hartimin e ligjeve, politikave publike apo ushtrimin e funksioneve;
<b>Ç</b>	Informacion për vendodhjen e zyrave, orarin e punës, emri dhe kontaktet e koordinatorit;	<b>H</b>	Informacion për sistemin që përdor autoriteti për mbajtjen e dokumentacionit publik pa kërkesë;
<b>D</b>	Informacion për arsimin, pagat e funksionarëve dhe detyrat e tyre;	<b>I</b>	Informacion për format e ndihmës shoqërore, subvencionet që jep autoriteti si dhe procedura për t'i përfituar;
<b>DH</b>	Informacion për planet strategjike të punës, raportet e performancës;	<b>J</b>	Informacion në lidhje me informacionin dhe dokumentat që kërkohen më shpesh.
<b>E</b>	informacion për buxhetin, planin e shpenzimeve, raportet vjetore;	<b>K</b>	
<b>Ë</b>	Informacion për listat e kontratave, shumën, palët kontraktuese, monitorimi i kontratave;		

Fig. 4 – Përbushja e kategorive të mësipërm të informacioneve në programin e transparencës



Një element i rëndësishëm që konstatohet është se listat e kontratave të prokurimeve, shumën, palët dhe monitorimin e kontratave (pika Ë). Keq paraqitet situata për

publikimin e informacioneve dhe dokumentacionit për planet e punës dhe raportet e performancës (pika DH), që rezultojnë të përbushura në një masë tepër të ulët.




# INDEKSI / TRANSPARENCA REAKTIVE

Përveç transparencës proaktive, Res Publica ka vlerësuar edhe sjelljen e institucioneve në rastin e trajtimit të kërkesave për informacion të dërguara nga qytetarët, gazetarët, aktivistët, etj. Ky aspekt është i një rëndësie më të madhe se

transparenca proaktive sepse një institucion mund të publikojë shumë informacione pa kërkesë, por nga ana tjetër mund të mos përgjigjet ndaj kërkesave specifike, çka mund të minojë tërësisht transparencën.

Fig. 5 - Indeksi i transparencës reaktive të institucioneve, Nëntor 2016 – Qershor 2017



Për vlerësimin e transparencës reaktive analiza ka nisur në muajin Janar 2019, sepse vetëm pas kalimit të afateve procedurale dhe pranimin të ankimeve nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, mund të vlerësojmë reagimin e institucioneve ndaj kërkesave për informacion.

Siç rezulton në grafikun e mësipërm, përveç një përkeqësimit në reagimin e pushtetit vendor, sjellja e institucioneve të tjerë ndaj kërkesave për informacion nuk ka ndryshuar gjatë gjithë periudhës, duke ruajtur një konstante në masën e refuzimit, dhënien e informacionit të paplotë, mosekzekutimin e vendimeve të Komisionerit, etj. Pushteti vendor duket se ka përkeqësuar


reagimin në muajin Maj e në vazhdim dhe ky moment lidhet me fushatën për zgjedhjet vendore të mbajtura në 30 qershor. Angazhimi në fushatë e ka bërë administratën e pushtetit vendor më neglizhente ndaj kërkesave për informacion. Situata ka mbetur e njëjtë në vijim.

Në një situatë të keqe duket se janë edhe institucionet qendrore të pushtetit ekzekutiv. Grupet e tjerë duken më të përgjegjshëm. Bie në sy një situatë e mirë në pushtetin gjyqësor, krahasuar me vitet e mëparshme. Duhet theksuar se në këtë rast gjykatat janë ndjeshëm më mirë se prokuroritë, të cilat mbeten në nivele të këqija reagimi, si më parë.

# INDEKSI / TRANSPARENCA REAKTIVE

## PËRMBUSHJA E PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Fig. 6 – Indeksi i përgjithshëm i transparencës reaktive në Janar - Shtator 2019



Nga grafiku i mësipërm, rezulton se indeksi i përgjithshëm i pikëve penalizuese është rritur nga 8.1 në Janar në 9.6 në Shtator 2019. Ndonëse shumë institucione nuk kanë ndryshuar qendrim ndaj kërkesave (as përmirësim dhe as përkeqësim), indeksi i përgjithshëm është ndikuar

kryesisht nga përkeqësimi i reagimeve të pushtetit vendor.

Ky indeks është nxjerrë pas testimit të bërë me një numër të përgjithshëm prej 251 kërkesash për informacion.

# INDEKSI / TRANSPARENCA REAKTIVE

## SHEMBUJ INSTITUCIONESH ME SJELLJE NEGATIVE LIDHUR ME KTHIMIN E PËRGGJIGJEVE

### INSTITUCIONET KUSHTETUESE DHE TË PAVARURA

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	- 25
Gjykata Kushtetuese	- 20
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë	- 20

### INSTITUCIONET QENDRORE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV

Ministria e Shtetit për Diasporën	- 50
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	- 50
Kryeministria	- 50
Ministria e Punëve të Jashtme dhe për Evropën	- 50
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	- 25

### INSTITUCIONET E VARËSISË

Inspektoriati i Punës	- 50
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	- 17

# INDEKSI / TRANSPARENCA REAKTIVE

## SHEMBUJ INSTITUCIONESH ME SJELLJE NEGATIVE LIDHUR ME KTHIMIN E PËRGJIGJEVE

### INSTITUCIONET E PUSHTETIT VENDOR

Bashkia Tropojë - 50

Bashkia Sarandë - 50

Bashkia Gjirokastrë - 50

Bashkia Himarë - 50

Bashkia Lushnjë - 50

### INSTITUCIONET E PUSHTETIT GJYQËSOR

Prokuroria e Përgjithshme - 50

# INDEKSI / TRANSPARENCA AGREGAT

## INSTITUCIONET E RENDITURA MË MIRË PAS REZULTATIT TË PËRGJITHSHËM

AUTORITETI PUBLIK	Proaktive	Reaktive	Total
1. Bashkia Shkodër	86	0	86
2. Komisioneri për të Drejtën e Informimit	75	0	75
3. Komisioneri Publik	73	0	73
4. Gjykata e Lartë	71	0	71
5. ALUIZNI	67	0	67
= Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	67	0	67
= Ministria e Kulturës	67	0	67
8. Autoriteti i Konkurrencës	61	0	61
9. Kolegji i Posaçëm i Apelimit	57	0	57
10. Agjencia e Prokurimit Publik	56	0	56
11. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	61	-7	54
12. Ministria e Mbrojtjes	53	0	53
13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	52	0	52

# INDEKSI / TRANSPARENCA AGREGAT


## INSTITUCIONET E RENDITURA MË KEQ PAS REZULTATIT TË PËRGJITHSHËM

AUTORITETI PUBLIK	Proaktive	Reaktive	Total
88. Kryeministria	41	- 50	- 19
89. Bashkia Lushnje	30	- 50	- 20
= Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	0	- 20	- 20
91. Prokuroria e Përgjithme	20	- 50	- 30
92. Bashkia Dibër	19	- 50	- 31
= Bashkia Himarë	19	- 50	- 31
94. Inspektoriati i Punës	16	- 50	- 34
95. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	15	- 50	- 35
96. Bashkia Tepelenë	0	- 40	- 40
97. Bashkia Gjirokastrë	0	- 50	- 50
= Bashkia Sarandë	0	- 50	- 50
= Bashkia Tropojë	0	- 50	- 50
= Ministria e Shtetit për Diasporën	0	- 50	- 50

# IV. TË DHËNA TË TJERA

## CAKTIMI I KOORDINATORËVE & REGJISTRI I KËRKESAVE


Fig. 7 - Caktimi i koordinatorit për të drejtën e informimit



Fakti që ende pas disa vitesh, 1/4 e institucioneve nuk kanë caktuar një koordinator për të drejtën e informimit. Ky është minimumi i seriozitetit që duhet të tregojë një institucion publik në respekt të ligjit për të drejtën e informimit. Marrë së bashku me faktin që programet e transparencës janë plotësuar në

masë tepër të dobët, tregon që kemi të bëjmë me shumë pak tryzni të ushtruar nga organi kujdestar i ligjit që është Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Dukshëm ky organ, përveç disa praktikave të mira që ka prodhuar në trajtimin e ankesave, nuk po arrin t'i japë ligjit një dimension normal zbatimi.

Fig. 8 – Plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve për informacion



Vlen të theksohet se nga institucionet që kanë një regjistër dhe e kanë të plotësuar, vetëm një institucion ka përgjigje të aksesueshme, ndërsa

pjesa tjetër informon se është dhënë një përgjigje, por pa publikuar përgjigjen. Pothuajse gjysma nuk ka regjistër, 5 vjet pas miratimit të ligjit.


# TË DHËNA TË TJERA

## TRAJTIMI I GAZETARËVE, KRAHASUAR ME QYTETARËT E TJERË

Për të pasur një tablo, se si reagojnë institucionet kur kërkesa dërgohet nga qytetarët në krahasim me kërkesat e hartuara nga gazetarët, më poshtë do bëjmë një krahasim midis këtyre dy kategorive

gjatë vitit 2019. Krahasimi do të bëhet duke pasur parasysh elementët si: plotësia e përgjigjes, kohëzgjatje e kthimit të saj dhe reagimin e institucioneve pas ankimeve administrative.


Fig.9 - Përqindja e përgjigjeve të plota ndaj kërkesës fillestare



Siç vihet re nga grafiku i mësipërm, në rastin e kërkesave të gazetarëve investigues, përqindja e përgjigjeve është më e ulët, duke demonstruar se gazetarët trajtohen më keq se qytetarët e

zakonshëm. Shpjegimi më i arsyeshëm është që gazetarët bëjnë pyetje më të vështira, për çështje më “të nxehta”, që lidhen me afera të dyshuara.

Fig.10- Përqindja e përgjigjeve brenda afatit ligjor






# TË DHËNA TË TJERA

## TRAJTIMI I GAZETARËVE, KRAHASUAR ME QYTETARËT E TJERË


Fig.11 - Përqindja e rasteve për t'u trajtuar me ankim



Siç vihet re nga grafiku, gazetarët kanë pasur nevojë për ankim në më shumë raste. Institucionet publike nuk lëvrojnë lehtësisht informacionet e kërkuara nga gazetarët. Madje

në 9% të rasteve ata i drejtohen gjykatës, pasi as Komisioneri për të Drejtën e Informimit nuk e garanton gjithmonë këtë të drejtë.

Fig.12- Shpejtësia e përgjigjes ndaj kërkesës fillestare (në ditë kalendarike)



Në përgjithësi nuk vihet re diferencë kohore në përgjigjen ndaj gazetarëve apo qytetarëve të tjerë (në rastet kur ka përgjigje). Por, theksojmë se afati i marrjes së përgjigjes rritet ndjeshëm në rastin e gazetarëve, të cilët detyrohen të ndjekin

rrugët e ankimit administrativ dhe gjyqësor. Ende nuk raportohen raste kur gjykata të ketë akorduar dëmshpërblim për vonesën e lëvrimit të informacionit, por Res Publica ka nisur disa çështje me qëllim formimin e një praktike të re.

## V. KONKLUZIONE

- Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së programeve të transparencës shënoi pikën më të lartë në muajt Maj-Qershor 2019, në masën 26.5%. Ndonëse shumë e ulët, kjo është shifra më e lartë e regjistruar ndonjëherë nga Res Publica që në vitin 2014 kur u miratua ligji i ri.
- Rezulton se 5 institucionet më transparente janë Bashkia Shkodër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri Publik, Gjykata e Lartë dhe Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.
- Kategoria e institucioneve kushtetuese, institucioneve të pavarura dhe ato të pushtetit qendror janë në një situatë më të mirë krahasuar me të tjerat. Vihet re një përmirësim i lehtë në muajt e parë të vitit 2019, por me një rënie në muajt Qershor-Korrik. Fakti që institucionet e prekura janë ato të pushtetit ekzekutiv qendror dhe të pushtetit vendor, sugjeron që kjo lidhet me situatën zgjedhore të tensionuar, në këtë periudhë.
- Nga 100 autoritetet e monitoruar rezulton se 25% nuk kanë fare program transparence, madje disa autoritete nuk kanë as faqe interneti. Pjesa më e madhe e autoriteteve është vlerësuar me 0 deri 50 pikë, thënë ndryshe ato kanë përmbushur më pak se gjysmën e kërkesave ligjore. Vetëm 16% e institucioneve kanë plotësuar më shumë se gjysmën e kërkesave ligjore, ku asnjë prej tyre nuk ka përmbushur plotësisht programin e transparencës. Krahasuar me dy vjet më parë situata nuk ka asnjë përmirësim.
- Konstatohet se lista e kontratave, prokurimeve, monitorimi i tyre nuk publikohen në programet e transparencës edhe pse ky është detyrim ligjor. Njësoj keq paraqitet situata për publikimin e informacioneve për planet e punës dhe raportet e performancës, që rezultojnë të përmbushura në një masë tepër të ulët.
- Lidhur me vlerësimin e transparencës reaktive vihet re se kemi një përqendrim në reagimin e pushtetit vendor sidomos në muajt Maj dhe Qershor, moment që lidhet me fushatën zgjedhore. Ndërsa sjellja e institucioneve të tjera ndaj kërkesave për informacion nuk ka ndryshuar gjatë gjithë periudhës, duke ruajtur një konstante në masën e refuzimit, dhënien e informacionit të paplotë, mos ekzekutimitin e vendimeve të Komisionerit, etj. Vihet re se pushteti gjyqësor ka një përmirësim të situatës krahasuar me vitet e mëparshme.
- Indeksi i përgjithshëm i transparencës reaktive në total vlerësohet të jetë përqendruar me numër pikësh penalizuese mesatare nga 8.1 në Janar 2019 në 9.6 në Shtator 2019. Këtu ndikimi më negativ vjen nga sjellja e pushtetit vendor.
- Fakti që ende pas disa vitesh, 1/4 e institucioneve nuk kanë caktuar një koordinator për të drejtën e informimit, tregon për mungesë të minimumit të seriozitetit që duhet të tregojë një institucion publik në respekt të ligjit për të drejtën e informimit. Marrë së bashku me faktin që programet e transparencës janë plotësuar në masë tepër të dobët, tregon që kemi të bëjmë me shumë pak trysni të ushtruar nga organi kujdestar i kësaj pjese të ligjit, - Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Dukshëm ky organ, përveç disa praktikave të mira që ka prodhuar në trajtimin e ankesave, nuk po arrin t'i japë ligjit një dimension normal zbatimi.
- Në rastin e kërkesave të gazetarëve investigues, përqindja e përgjigjeve është më e ulët, duke demonstruar se gazetarët trajtohen më keq se qytetarët e zakonshëm. U vu re se gazetarët kanë pasur nevojë për ankim në më shumë raste (50% më shumë). Institucionet publike nuk lëvrojnë lehtësisht informacionet e kërkuara nga gazetarët. Madje në 9% të rasteve ata i drejtohen gjykatës, pasi as Komisioneri për të Drejtën e Informimit nuk e garanton gjithmonë këtë të drejtë. Shpjegimi më i arsyeshëm për këtë situatë është që gazetarët bëjnë pyetje më të vështira, për çështje më “të nxehta”.
- Vazhdon të paraqitet problematik plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, ku vlen të theksohet se nga institucionet që kanë një regjistër dhe e kanë të plotësuar, vetëm një institucion ka përgjigje të aksesueshme, ndërsa pjesa tjetër informon se është dhënë një përgjigje, por pa publikuar përgjigjen. Pothuajse gjysma nuk ka regjistër, 5 vjet pas miratimit të ligjit.

# IV. REKOMANDIME

## Rekomandimi nr. 1

Një nga rekomandimet e bëra edhe në studime të mëparshme ka qenë edhe përshtatja e programit të transparencës sipas natyrës së organeve publike. Është vënë re që Komisioneri ka përshtatur modelin e transparencës së Bashkive, dhe ka rekomanduar përshtatjen e modelit të transparencës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Megjithatë jo të gjitha Bashkitë kanë përshtatur programin e transparencës me modelin e vënë në dispozicion nga Komisioneri dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk e a marrë parasysh kërkesën e Komisionerit për përshtatjen e Programit të Transparencës.

## Rekomandimi nr. 2

Rekomandohet të vijojnë trajnimet e koordinatorëve për të drejtën e informimit, sidomos lidhur me programet e transparencës, pasi ata kanë vështirësi për të kuptuar dispozitat e ligjit për të drejtën e informimit dhe në mënyrë të veçantë plotësimin e programit të transparencës.

## Rekomandimi nr. 3

Vijojmë të rekomandojmë që është e nevojshme që të përfshihet si shkelje administrative mos caktimi i koordinatorit nga titullari i autoritetit publik dhe si rrjedhojë të parashikohet një dënim me gjobë në rastin e konstatimit të kësaj shkeljeje. Shprehim mendimin se duhet të bëhet patjetër një ndërhyrje legjislative me qëllim ushtrimin e presionit ndaj titullarëve të autoriteteve publike, që ende nuk kanë caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit.

## Rekomandimi nr. 4

Të shtohet presioni kundër autoriteteve publike që shkelin ligjin për të drejtën e informimit, pavarësisht qendrimeve të mëparshme të Komisionerit, i cili duhet të aplikojë ndëshkime ndaj funksionarëve që vazhdojnë të refuzojnë të lëvrimin e informacionit brenda afateve ligjore, nuk plotësojnë programin e transparencës, duke u sjellë si përsëritës të shkeljes.



[www.respublica.org.al](http://www.respublica.org.al)  
[www.publeaks.al](http://www.publeaks.al)